

Më
Dana 10 - 12 - 2018



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:007110
Datë: 14.05.2018
Numri i dokumentit: 00036645
P.nr.177/16

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.177/16

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin individual Faton Ajvazi dhe me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen penale kundër të akuzuarve [REDACTED] nga Ferizaj, rr [REDACTED], nr. [REDACTED] dhe [REDACTED] nga Ferizaj, rr [REDACTED], për shkak të veprës penale në bashkëkryerje uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1, lidhur me nenin 31, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP//II.nr.318-6/15, më datë 29.02.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e Prokurorit të Shtetit Valdet Avdiu, të dëmtuarit [REDACTED] dhe të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED], me datë 18.04.2018 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 11.05.2018, përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

I akuzuari [REDACTED], i lindur me [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], me vendbanim në Ferizaj, Rr. [REDACTED], nr. [REDACTED] kë të kryer shkollën e mesme, tregtar, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar dhe baba e katër fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari [REDACTED] i lindur më datë [REDACTED], nga babai [REDACTED] dhe nëna [REDACTED], e gjinisë [REDACTED], me vendbanim në Ferizaj, rr [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, me profesion menagjer, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuari [REDACTED]

Në bazë të nenit 363, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, të KPPK-së.

REFUZOHET AKUZA

Se gjatë muajit nëntor 2014, në rrugën "Vëllezërit Gërvalla", në Ferizaj, afër pompës së benzinës "Kema Petrol", në mënyrë të kundërligjshme kanë uzurpuar pronën e paluajtshme në sipërfaqe prej 338 m² dhe 61 m², të identifikuar me certifikatat kadastrale me nr.P-72217092-01475-0 dhe P-72217092-01472-3, zona kadastrale Ferizaj, pronë e të dëmtuarit [REDACTED] [REDACTED] ashtu që në këto parcela kanë vendosur një veturë të vjetër dhe një kamionetë, me ç'rast i kanë pamundësuar të dëmtuarit ta shfrytëzojnë pronën e tijë.

Me qka do të kryentë veprën penale në bashkëkryerje uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1, lidhur me nenin 31, të KPRK-së,

Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza në mënyrë shqyrtimin gjyqësor

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve burxhetore të gjykatës.

I akuzuari [REDACTED]

ËSHTË FAJTOR

Sepse

Gjatë muajit nëntor 2014, në rrugën "Vëllezërit Gërvalla", në Ferizaj, afër pompës së benzinës "Kema Petrol", në mënyrë të kundërligjshme kanë uzurpuar pronën e paluajtshme në

sipërfaqe prej 338 m² dhe 61 m², të identifikuar me certifikatat kadastrale me nr.P-72217092-01475-0 dhe P-72217092-01472-3, zona kadastrale Ferizaj, pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR], ashtu që në këto parcela kanë vendosur një veturë të vjetër dhe një kamionetë, me ç'rast i kanë pamundësuar të dëmtuarit ta shfrytëzojnë pronën e tijë.

Me qka ka kryer veprën penale në bashkëkryerje uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1, lidhur me nenin 31, të KPRK-së,

me këtë kreu veprën penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit të sipërcekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 51, 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, e

GJYKON DËNIM ME KUSHTE

- Të pandehurit i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 8 /tetë/ muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej 2 /dy/ viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
- I pandehuri urdhërohet t'i largoj sendet e luajtshme siq janë vetura e vjetër dhe kamioneta nga ngastrat kadastrale nr.01475-0 dhe 01472-3, ZK Ferizaj, pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR]
- Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

- I dëmtuari [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike, udhëzohet në kontest civil.
- Obligohet i akuzuari [REDAKTUAR] që konform nenit 39, par 3, pika 3.1, të Ligjit Nr.05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 euro, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm në Ferizaj, ka sjellë për gjykim çështjen penale sipas aktakuzës PP/II.nr.318-6/15, të datës 29.02.2016, me të cilën ka akuzuar të pandehurit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për veprën penale në bashkëkryerje uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par. 1, lidhur me nenin 31, të KPRK-së, dhe në shqyrtim gjyqësor ka propozuar që të pandehurit [REDAKTUAR] t'i shqiptojë sanksion penal të parapar me ligj kurse për të pandehurin [REDAKTUAR] është tërhequr nga akuza

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet Përpara kësaj gjykate. Gjitashtu kjo çështje penale është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar kjo çështje penale gjykohet nga gjyqtari individual dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt. 04.04.2018, në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit, lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehuri [REDAKTUAR] e ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 par. 1 të KPPK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pasi që i akuzuari [REDAKTUAR] nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i

ndërlidhur reciprokisht me njëra tjetrën, në bazës të nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, vërtetohet gjendjen e fakteve të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Rrethanat e faktit të çështjes lidhur me këtë procedim kanë rezultuar si me poshtë:

Nga shkresat e lëndës rezulton se i dëmtuari [REDAKTUAR] më date 04.02/2014, ka paraqitur rastin uzurpim prone në Stacionin e Policisë në Ferizaj po ashtu i njëjti në polici ka dorzuar edhe dokumentacionin e nevojshëm që vërteton se [REDAKTUAR] është pronar legjitim i ngastrave kadastrale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi që janë objekt uzurpimi. Pas hapjes se rastin në PK-Ferizaj, janë intervistuar në polici në cilsinë e të dyshuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] dhe se i pandehuri [REDAKTUAR] në deklaratën e dhënë në polici ka deklaruar se kamionetën e tij e ka parkuar-vendosur në pronën e të dëmtuarit [REDAKTUAR] me arsyetim se këtë pronë i dëmtuari e ka blerë pa e pyetur fare të pandehurin [REDAKTUAR] dhe se ka deklaruar gjithashtu se e ka penaguar të dëmtuarin sepse nuk siq ka deklaruar “nuk kemi qef që ky person që qëndrojnë në mesin e pronave tona”.

I dëmtuari [REDAKTUAR] në lidhje me këtë çështje penale ka deklaruar në shqyrtimin gjyqësor se: parcelat i kam blerë më datë 21.05.2011, ku kam edhe kontratën të vërtetuar si dhe i kam në pronësi këto parcela. Pas një viti kur kam dërguar bagerin për të prishur objektet e vjetra ku punët ka qenë duke i kryer firma [REDAKTUAR], para drekës nuk kanë dalë asnjëri nga këta derisa është rrafshuar objekti i vjetër, diku rreth orës 12:00 ka dalë [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] ka dalë [REDAKTUAR], na kanë kërcënuar dhe unë në atë moment i kam thirrë policinë ku të njëjtit atë ditë i kanë kërcënuar edhe policinë dhe kur e kam blerë këtë pronë nuk kam pasur kurrfarë kontakti me ta derisa kanë filluar punimet, nuk më kanë treguar arsyen përse më kanë penguar por besoj se është interesi i tyre për përfitime materiale. Pas dy viteve unë kam dërguar disa punëtorë dhe vëllaun tim për ta rrethuar tokën dhe kanë dalur i akuzuari [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] ndërsa nuk ka dalur [REDAKTUAR] dhe të cilën ju kanë shkaktuar edhe dhunë punëtorëve. Sakt nuk e di se kush i ka vendosur tjetër kush mirëpo veturat i kanë qenë të tyre (i referohet të akuzuarve) dhe sa i përket hedhjes së mbeturinave në pronën time të njëjtat i kanë hedhur të akuzuarit dhe që 7-8 vite e shfrytëzojnë parcelën time të akuzuarit të cilët e kanë uzurpuar ngase unë gjatë këtyre viteve e kisha lëshuar me qira.

I pandehuri [REDAKTUAR] në lidhje me këtë procedim penal ka deklaruar në shqyrtimin gjyqësor se: deklaratën në polici e kam dhënë me vullnet të plotë, të njëjtën e ka nënshkruar, qëndroj në tërësi pranë saj dhe kamionetën e vendosur në pronën e të dëmtuarit pasi që më ka ftuar hetuesi, e kam hequr menjëher nga aty dhe kjo pronë kufizohet me të gjitha pronat tona dhe i dëmtuari kur e ka blerë këtë pronë është dashur të pyes po nuk e ka pyetur kërkënd dhe ka ardhur deri të kjo mosmarrëveshje.

Sa më sipër, u provua në gjykimin e çështjes me provat e paraqitura nga organi i akuzes dhe të administruara nga Gjykata në seancë gjyqësore, ndër të cilat theksohen: ekzistenca e faktit është provuar se i pandehuri [REDAKTUAR] e ka bërë uzurpimin e paligjshëm të pronës, ngastrave të të dëmtuarit të specifikuara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, përkatësisht në to e ka vendosur kamionetën e tij dhe një veturë të vjetër. Dhe kjo vërtetohet nga certifikata e pronës së paluajtshme me numër 100276 2014, e datës 19.12.2014 dhe 43521-2015, e datës 21.08.2015, prova këto që vërtetojnë edhe faktin se ngastrate uzurpuara janë pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR].

Argumentat juridike, interpretimi i dispozites penale referuese, analiza e provave dhe konkluzionet e Gjykes.

Në këto rrethana, e ndodhur përpara faktit të parashtruar me sipër, pretendimeve dhe provave në gjykim, Gjykata çmon se në veprimet e të pandehurit [REDAKTUAR] janë të pranishme të gjitha elementet që kërkon legjislacioni penal për t'i cilësuar këto veprime si elemente të figurës së veprës penale të uzurpimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme, në dëm të të dëmtuarit [REDAKTUAR], të parashikuar nga neni 332 par. 1, të KPRK-së.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi nga dëgjimi i dëshmitarit/dëmtuarit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], i cili në mënyrë bindëse dhe objektive dëshmoi për faktet relevante, kohën dhe vendin dhe mënyrën se si i pandehuri e ka uzurpuar pronën e të dëmtuarit me vendosjen e kamionetës së tij në këtë pronë dhe kështu pengimin që i dëmtuari ta shfrytëzoj pronën e tij.

Gjykata gjene se neni 332 i KPRK-së, parashikon: "Uzurpim i paligjshëm i pronës përbën veprë penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjere në dy vjet"

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme në mënyrë që shkelja e kësaj dispozite të cilësohet nga ligji si vepër penale duhet që: objekt i veprës penale të jenë marrdheniet juridike të vendosura me ligj që sigurojnë regjimin juridik të pronës të mbrojtur posaçërisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale me veprime aktive, të kundërligjshme të ketë shkelur ligjin. Këto shkelje duhet të kenë sjellë pasoja për personat e tjere ose komunitetin si pushtimit pa të drejtë të tokës në dëm të pronës së tjetrit ose duke e zënë pa leje tokën siq është vërtetuar në këtë çështje penale.

Nga ana subjektive, uzurpimi i tokës kryhet me dashje, nga personi i përgjegjshëm dhe me veprime aktive.

Vlerësimi i mbrojtjes: në shqyrtimin gjyqësor i pandehuri [REDAKTUAR] edhe përkundër qëndrimit mohues se nuk është uzurpator, pranon faktin se e ka vendosur kaomionetën e tij në pronën e të dëmtuarit dhe se këtë e ka larguar më vonë, gjithashtu e ka pranuar faktin se ka probleme me të dëmtuarin dhe se ka deklaruar se i dëmtuari është dashru ta pyes atë kur e ka blerë këtë pronë, por një mbrojtje të tillë gjykata nuk e aprovoj, nga fakti se i pandehuri nuk ishte në gjendje të ofroj një fakt me të cilin do ta provonte se nuk është uzurpues i pasurisë se paluajtshme të huaj dhe i pandehuri pas kërkesës së të dëmtuarit ka qenë i obliguar ta liroj o me kërkesë ose pa kërkesë.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethana lehtësuese i mori parasysh sjelljen e tij korrekte, ndërsa në mungesë të rrethanave veqanarisht rënduese Gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarin dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi bazë të këtyre rrethanave i vërtetoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata të pandehurit i shqiptoj dënim me burg prej 8 /tetë/ muaj të cilin dënim urdhëroj të mos ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej dy viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, si duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, qëllimi ndëshkimor të dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale i paraparë nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata me rastin e refuzimit të akuzës për të pandehurin [REDAKTUAR], është bazuar në faktin që prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor është tërhequr nga ndjekja e mëtejme

penale ndaj të pandehurit [REDAKTUAR] dhe Gjykata për këtë arsye në bazë të nenit 363, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, të KPPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për të akuzuarin [REDAKTUAR]

I demtuari [REDAKTUAR] ka paraqitë kërkesë pasurore-juridike dhe i është bashkangjitur ndjekjes penale për të akuzuarit.

I demtuari [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Konformnenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € pas plotfuqishmëris së aktgjykimit nën kërcënimin të ekzekutimit me dhunë, si dhe shumën prej 30 euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit në bazë të nenit 39, par 3, pika 3.1, të Ligjit Nr.05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr.177/16, me datë 11.05.2018.**

**Sekretare Juridike,
Makfire Reçica**

Gjyqtari Individual,

Faton Ajvazi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.